

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandal te universiteti 'Ismail Qemali' në Vlorë! Shqiptarët mezi ia dalin, studentët e huaj ftohen me të gji tha shpenzimet e paguara
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/skandal-te-universiteti-ismail-qemali-ne-vlore-shqiptaret-m-ezi-ia-dal-i46696
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 10:19:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 09:33:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9b5122492fae79e2997acc9f66dba526d7245e28294c8bf6899c3a92c304211d
TEKSTI	4a216839279a512d7d9751f4ffdb29eb632c7de06efeb0bbfc1ba1e873ed7845
PAMJA	0a94325158feb5b81c2e1ab1e45cace1e4a015647956c76d14cf0ad79505d92a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1e9805ee8e756bf93e9821d21150601d6333e829ebf9bc48b9c5ced30d552209
E MËPARSHMJA	279914e7fa00d9ab99fa378396db017c431d64eb8b5504fedccf0dfffd5cfc75
RRËNJJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1e9805ee8e756bf93e9821d21150601d6333e829ebf9bc48b9c5ced30d552209>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Në Kuvend debat për dënimin e liderëve të UÇK dhe pagat e gjyqtarëve, jashtë protestuesit përplasen me policinë](#)

17 Shtator 2026, 12:10

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-
-

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 17 Shtator 2026, 11:33

Skandal te universiteti ‘Ismail Qemali’ në Vlorë! Shqiptarët mezi ia dalin, studentët e huaj ftohen me të gjitha shpenzimet e paguara

Në 2018-ën u deshën protesta të studentëve shqiptarë për uljen e tarifave studentore të cilat sërish rëndojnë xhepin e të rinjve shqiptarë, por mesa duket për studentët e huaj, universitetet gjejnë fonde për t’ju mbuluar çdo shpenzim.





Ndërkohë që të rinjtë shqiptarë hasin vështirësi në pagesën e faturave dhe të kostove të studimeve duke u detyruar shpesh të marrin edhe kredi, universitetet shqiptare duket se nuk e kanë këtë shqetësim, por përqendrohen që të sigurojnë të gjitha kushtet për studentët e huaj.

Rasti konkret dhe më flagrant është shënuar së fundmi në Vlorë në universitetin "Ismael Qemali". Me anë të një shkrese që mban datën 11 shtator 2026, rektorja e këtij universiteti, Aurela Saliaj i kërkon Bordit të Administrimit që të lehtësojë procedurat për studentët e huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në këtë universitet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË
REKTOR

Nr. 2404 Prot.

Vlorë, më 11.09.2026

Lënda: Kërkesë për miratimin e lëshimit të ftesave për studentët e huaj dhe përcaktimin e autoritetit përgjegjës për nënshkrimin e tyre

BORDIT TË ADMINISTRIMIT
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
Kryetares së Bordit të Administrimit
Znj. Saniela Xhaferi

E nderuar znj. Xhaferi,

Në kuadër të ndërkombëtarizimit të veprimtarisë akademike të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë, si dhe me qëllim lehtësimin e procedurave administrative për studentët e huaj që do të ndjekin programe studimi apo forma të tjera të bashkëpunimit pranë Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë; në zbatim të Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, lind nevoja për përcaktimin e një procedure të qartë për lëshimin e ftesave zyrtare në emër të Universitetit.

NR 1008/2026 - Lëshimi i ftesave administrative të Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismael Qemali"

... të kësaj lloji, të cilat janë të përcaktuara nga Administrimi i Universitetit "Ismael Qemali"
Vlorë të ketë të drejtën të lëshojë ftesa zyrtare për studentët e huaj, sipas rasteve dhe
nevojave të përcaktuara në kuadër të veprimtarisë së Universitetit.

Gjithashtu, me qëllim garantimin e një procedure të unifikuar dhe të qartë institucionale,
kërkojmë që Bordi i Administrimit të përcaktojë gjithashtu autoritetin përgjegjës për
nënshkrimin e kësaj ftesave.

Për sa më sipër, lutemi që kjo çështje të shqyrtohet nga Bordi i Administrimit dhe të merret
vendimi përkatës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

REKTOR

PROF. DR. Aurela Saliaj

Adresa /Address: Boulevardi Vlorë-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.uivlora.edu.al
e-mail: info@uivlora.edu.al



Në formularin e përgatitur për këtë synim, vihet re se në ftesën për vizë të posaçme për studentët e huaj, flitet për 4 pika që kanë të bëjnë me mbulimin e çdo shpenzimi që studentët e huaj do të kenë gjatë qëndrimit në Shqipëri duke nisur nga strehimi e deri tek ushqimi, shërbimi shëndetësor apo biletat e udhëtimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
REKTOR

FTESË PËR VIZË

Unë i nënshkruari/a _____, lindur më datë _____,
në (rrethi i lindjes) _____, me shtetësi _____, banues/c në adresën
Rruga: _____, Nr. _____ Shk./Ap. _____ Rrethi _____, me punë (funksionin)
_____ Emri i Kompanisë/Institucionit _____
në Adresën Rruga: _____, Nr. _____ Shk./Ap. _____ Rrethi _____, nr. kontakti shqiptar
(celular/zyrë) _____ me dokument identifikimi _____, i
ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e parashikuara në nenin 17 dhe nenin 141 të Ligjit nr. 79/2021
"Për të huajt":

Deklaroi:

Se ftoj në Shqipëri:

- 1) Bahar Acar, e lindur më datë 21.01.2006, në Isparta, me shtetësi Turke, mbajtëse e pasaportës me nr. Serie: U88487340 dhe vlefshmëri deri më datë 21.01.2031;

Lidhja me të ftuarën lidhet me ndjekjen e studimeve pranë Universitetit "Ismail Qemali" nga data 02.03.2026 deri më datën 10.07.2026, për motive studimi.

Gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri garantoj se:

- a) do t'i sigurojë të huajt/ve sistemimin dhe vend qëndrimin gjatë kohës së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;
- b) të mbulojë koston e kujdesit shëndetësor dhe largimin;
- c) të shpërblejë të tretët nga dëmet që u kanë ardhur për mos përmbushje të detyrimeve të marra përsipër në ftesë;
- e) do të mbulojë shpenzimet e kthimit në vendin e destinacionit, në rast se për të huajin është nxjerrë një urdhër largimi, largimi me forcë ose dëbimi dhe ky nuk ka mjete financiare;

Gjithashtu, jam njohur me pasojat ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 79/2021 "Për të huajt" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në rast të mosplotësimit të detyrimeve të sipërpërmendura.

DEKLARUESI

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

Së fundmi në Shqipëri ka patur regjistrime të shumta të studentëve nga India kryesisht në universitete private për degën e infermierisë.

Ajo çfarë më të drejtë ngjall habi dhe debate me të drejtë mes qytetarëve është sesi shteti nuk përqendrohet në përmirësimin e kushteve të arsimit dhe lehtësimin e shpenzimeve për studentët shqiptarë, por duket i investuar në tërheqjen e studentëve të huaj duke u paguar çdo shpenzim. Nga ana tjetër të rinjtë shqiptarë detyrohen të largohen jashtë vendit për shkak të kostove të larta të jetesës dhe mungesës së mundësive në tregun e punës. **Versus.al**

Tags:

[universitetet arsimit ne shqiperi vlore](#) [universiteti ismail qemali](#)

Poll



AKTUALITET

[“Qenkan të gjithë shqiptarët hajduta pra”, me cigare në dorë Kryemadhi këshillon protestuesit: S'keni gjë në vija](#)

17 Shtator 2026, 12:29

^ekstrakti^





AKTUALITET

Përplasje me policinë jashtë Kuvendit, protestuesit tentojnë të heqin kordonin metalik

17 Shtator 2026, 11:51

^ekstrakti^



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.